



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Administratës



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 201700042/6

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2017

**Lënda :** *Marrjen e masave të menjëhershme për lëshimin e certifikatave "Për vërtetim pronësie", për pasuritë e njohura në pronësi me të drejtë kthimi në natyrë sipas Vendimit Gjyqësor Civil të formës së prerë nr.343, datë 25.05.2015, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Gjirokastër, ndryshuar me Vendimin nr.524, datë 23.09.2015, të dhënë nga Gjykata e Apelit, Gjirokastër.*

**Drejtuar :** Regjistruesit të ZVRPP,

**TEPELENË**

**Për dijeni :** Kryeregjistruesit të Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme  
Z.Illirjan Muho

Sekretarit të Përgjithshme pranë Ministrisë së Drejtësisë

**TIRANË**

**M.Gj.**  
Adresa:

**TIRANË**

Z.Regjistrues!

Në përgjigje të kërkesës së Institucionit të Avokatit të Popullit nr.K3/M2-2 Prot, datë 01.02.2017, ju, me Tuajën nr. 215/1 Prot, datë 21.02.2017, keni mundësuar dhënien e informacionit dhe shpjegimeve rreth çështjes së prezantuar prej shtetases M.Gj. Referuar përgjigjes tuaj, konstatojmë se, pasuritë e ZK 2646, ku dhe ndodhen pronat e ankueses, i janë nënshtruar procedurës së regjistrimit fillestar sikurse parashikuar në nenin 24, 25, 26, 27 të ligjit nr.33/2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", të ndryshuar, duke nxjerrë me këtë rast dhe kartelat e pasurisë së paluajtshme për sejcilën pronë, dhe se moslëshimi i certifikatave të pronësisë në favor të ankueses ndodh për shkak se ; " ...zona nuk është hedhur në serverin e ZVRPP, Tepelenë, që dhe ne më pas të fillojmë me lëshimin

*e ... (akteve të pronësisë) dhe se me t'u hedhur zona në serverin e zyrës qendrore(???) nga ana jonë do fillohet me lëshimin e certifikatës”.*

Situata si më sipërprezantuar nga ana juaj, nuk mund të justifikoj mosdhënien e shërbimit të kërkuar prej ankueses, zj.Gj, për lëshimin e certifikatave të pronësisë për pasuritë e fituara në pronësi sipas Vendimit Gjyqësor të formës së prerë nr.343, datë 25.05.2015, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Gjirokastër, ndryshuar me Vendimin nr.524, datë 23.09.2015, të dhënë nga Gjykata e Apelit, Gjirokastër, me objekt;

*“Anullimin e pikës 2 të Vendimit nr.547, Datë 02.11.2012, të AKKP, Tiranë.*

*Njohjen e pronësisë të T.K. të sipërfaqes 15250m<sup>2</sup>, ndodhur në Memaliaj, Rrethi Tepelenë.*

*Kthimin në natyrë trashëgimtarëve të T.K. të pronës në parcel A1= 7920m<sup>2</sup>, A2= 1520m<sup>2</sup>, A3= 288m<sup>2</sup>, A6= 650m<sup>2</sup>, A7 587m<sup>2</sup>, me sipërfaqe totale 10964m<sup>2</sup>.*

*Kompesimin për sipërfaqen prej 4286m<sup>2</sup> në një nga format e parashikuar nga ligji”.*

Me rastin e ligjërimit të regjistrimit fillestar të pronave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit gjyqësor të lartpërmendur, sikurse parashikuar në nenin 27 të ligjit nr.33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar, është detyrim për ZVRPP, Tepelenë, të lëshoj në favor të subjektit pronar dokumentet e pronësisë, përfshirë dhe certifikatën për vërtetim pronësie. Moslëshimi i certifikatave të pronësisë për pasuritë e fituara në pronësi nga ana e ankueses me pretendimin se ; “... zona nuk është hedhur në serverin e ZVRPP, Tepelenë, ...”, nuk gjen mbështetje në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, të cilat përcaktojnë procedurat dhe mënyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme si dhe lëshimin e dokumenteve të pronësisë subjektit pronar.

Qëndrimi i mbajtur prej organit që ju përfaqësoni, në procesin e ekzekutimit të Vendimit Gjyqësor Civil të formës së prerë nr.343, datë 25.05.2015, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Gjirokastër, ndryshuar me Vendimin nr.524, datë 23.09.2015, të dhënë nga Gjykata e Apelit, Gjirokastër ka cënuar dhe cënon marrëdhëniet juridike të vendosura me ligj për ekzekutimin e titujve ekzekutiv, të cilat sigurojnë jo vetëm veprimtarinë e rregullt të organit që ju përfaqësoni, por dhe mbrojtjen e interesave të ligjshme të shtetasve apo të shtetit, të mbrojtura posaçërisht nga legjislacioni penal kundër veprimeve ose mosveprimeve kriminale.

Funksionimi i organit që ju përfaqësoni në zbatimin e këtij vendimi gjyqësor, konstatohet se, nuk vjen në respektim të parimit të ligjshmërisë, parimit e dhënies së ndihmës aktive, drejtësisë dhe paanësisë, deburokratizimit dhe i efikasitetit, të parashikuara në nenin 4, 10, 13, dhe 18 të Kodit të Procedurës Administrative dhe detyrueshme në kuptim dhe zbatim të nenit 2 të këtij Kodi.

Qëndrimin e derisotëm të mbajtur nga ana juaj e vlerësojmë në cënim të së drejtës së pronësisë, parimit për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, sikurse sanksionuar respektivisht në nenin 41, 42/2 të Kushtetutës, nenin 6/1 të Konvetës Europiane e të Drejtave të Njeriut (miratuar me ligjin nr.8137, datë 31.07.1996), nenin 1 të Protokollit nr.1 të Konvetës, si rrjedhojë e mosmarrjes së masave në afatin e vendosur për lëshimin e dokumenteve të pronësisë në favor të subjektit ankues.

Në situatën juridike në të cilën ndodhet çështja, Avokati i Popullit, nisur nga parimi i

zbatimit të ligjshmërisë, rritjes së efektivitetit në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, si dhe për një zgjidhje ligjore të këtij problemi çmon me vend të bëjë këtë rekomandim, duke shpresur se kështu do të ndihmojmë bashkërisht për vënien në vend të së drejtës të shkelur ankuesit në fjalë.

Për të gjitha këto arsye, në përputhje me nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë në të cilin sanksionohet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata publike”, si dhe nenin 21/b të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, i cili parashikon se : “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”,

## **REKOMANDOJMË**

*Marrjen e masave të menjëhershme për lëshimin e çertifikatave “Për vërtetim pronësie”, për pasuritë e njohura në pronësi me të drejtë kthimi në natyrë sipas Vendimit Gjyqësor Civil të formës së prerë nr.343, datë 25.05.2015, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Gjirokastër, ndryshuar me Vendimin nr.524, datë 23.09.2015, të dhënë nga Gjykata e Apelit, Gjirokastër.*

Lidhur me shqyrtimin që do të kryhet rekomandimit të dhënë, konform nenit 19 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, kthimi i përgjigjes duhet të bëhet brenda 30 ditëve nga data e dërgimit të kësaj shkrese.

*Duke besuar në bashkëpunimin tuaj.*

*Bashkëlidhur ju dërgojmë;*

*Kopje të shkresës nr.2015/1 Prot, datë 21.02.2017, të ZVRPP, Tepelenë, drejtuar Avokatit të Popullit.*

**KOMISIONERI**

**Etilda GJONAJ(SALIU)**

**Konceptoi dhe Daktilografoi**  
**A.Gjoleka**